

# RAPORTI VJETOR I AKTIVITETEVE 2019

A Rr. UÇK Nr. 273  
10000 Prishtinë  
Kosovë

T/F +381 38 213 227  
E [info@qkk-rks.com](mailto:info@qkk-rks.com)  
W [www.qkk-rks.com](http://www.qkk-rks.com)

## Përmbajtja

HYRJE .....	3
AKTIVITETET E QENDRËS KINEMATOGRAFIKE TË KOSOVËS .....	3
SUKSESET NË FESTIVALE .....	3
DITËT E FILMIT NË PËRKUJTIM TË FARUK BEGOLLIT .....	5
JAVA E FILMIT PËR SHËNIMIN E DITËS TË ÇLIRIMIT TË PRISHTINËS .....	6
JAVA E FILMIT TË KOSOVËS NË BUJANOC .....	6
PUNËTORI PËR SHKRIM SKENARI.....	7
PUNËTORI PËR PRODUCENTË .....	8
PROPOZIMI PËR OSCARS 2019.....	8
PUNIMET PËR DRAFT-LIGJIN E RI PËR KINEMATOGRAFI .....	9
PREMIERAT GJATË VITIT 2019 .....	9
MBLEDHJA PËRKUJTIMORE PËR ARZANA KRAJËN .....	10
PJESËMARRJA NË TREGJE TË FILMIT.....	10
BERLINALE.....	11
CANNES .....	11
BALKAN FILM MARKET .....	12
LES ARCS COPRODUCTION VILLAGE .....	12
PARTNERITETET DHE BASHKËPUNIMET NDËRKOMBËTARE .....	13
SOUTH EASTERN EUROPE CINEMA NETWORK .....	13
LES ARCS, FRANCË.....	14
ROTTERDAM LAB, HOLANDË .....	14
CINEUROPA, BELGIKË.....	14
MARRËVESHJA ME FIRST CUT LAB, GJERMANI.....	14
MARRËVESHJA ME FAMU, ÇEKI .....	15
MARRËVESHJA ME EAVE, FRANCË.....	15
ANËTARËSIMI NË BORDIN E EUROPEAN FILM PROMOTION .....	16
CEREMONIA E EUROPEAN FILM AWARDS, GJERMANI .....	16
VIZITË BASHKËPUNIMI NË TURQI.....	17
PROJEKTET FITUESE TË KONKURSIT TË QKK-së.....	17
PROJEKTET NË ZHVILLIM.....	20
PLANI 2020.....	20



## **HYRJE**

Qendra Kinematografike e Kosovës (QKK) është fondi publik i filmave dhe autoriteti qendror për kinematografinë në Kosovë që financojnë filma artistikë, filma të shkurtër, dokumentarë, filma animacioni, zhvillime të projekteve dhe post-produksionit. Në 5 vitet e fundit përmes përkrahjes së QKK-së dhe punës e bashkëpunimit të ngushtë me komunitetin filmbërës, kinematografia ka shënuar rritje eksponenciale të suksesit në arenën ndërkombëtare të filmit. Filmat e shkurtër, të gjatë dhe ata dokumentarë të Kosovës kanë rritur praninë e tyre në festivale të rëndësishme evropiane dhe botërore të filmit. Filmat kosovarë janë shfaqur në festivalet më të rëndësishme ndërkombëtare të filmave si Berlinale, Toronto, Sarajevë, Karlovy Vary, Montreal, Cairo, Goa, Tallinn e deri në nominimin për Oscars®. Gjatë 10 viteve të fundit Qendra Kinematografike e Kosovës ka mbështetur afër 140 filma në kategori të ndryshme dhe ka pasur bashkëpunime me shumë shtete që kanë forcuar industrinë e bashkëprodhimit të filmave.

## **AKTIVITETET E QENDRËS KINEMATOGRAFIKE TË KOSOVËS**

### **SUKSESET NË FESTIVALE**

Viti 2019 ishte më i suksesshmi deri tani për kinematografinë kosovare sa i përket pjesëmarrjes të filmave tanë në festivalet e kategorisë 'A'.

Filmat të cilët janë përzgjedhur nga një konkurrencë e hatashme botërore për t'u shfaqur në festivalet e kategorisë 'A' janë:

- Film i metrazhit të shkurtë 'Në mes' nga Samir Karahoda – Berlin International Film Festival – Kategoria kryesore: Filmat e shkurtë në Berlinale (Prodhim i Kosovës)
- Film i metrazhit të gjatë 'Shpia e Agës' nga Lendita Zeqiraj – International Film Festival Karlovy Vary – Kategoria: East of the west (Filmat nga ish-bloku socialist) (Bashkëprodhim i Kosovës, Kroacisë, Francës dhe Shqipërisë)
- Film i metrazhit të gjatë 'Zana' nga Antoneta Kastrati – Toronto International Film Festival – Kategoria: Discovery (Zbulimi) (Bashkëprodhim i Kosovës dhe Shqipërisë)
- Film i metrazhit të gjatë 'Cirku Fluturues' nga Fatos Berisha – Tallinn Black Nights Film Festival – Kategoria kryesore: Filmat e gjatë në Tallinn (Bashkëprodhim i Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë)
- Film i metrazhit të gjatë 'Ekzil' nga Visar Morina – Sundance Film Festival – Kategoria: Konkurenca e dramës më të mire botërore (Bashkëprodhim i Kosovës, Belgjikës dhe Gjermanisë)
- Film i metrazhit të gjatë 'Pranverë e Paharruar në Fshatin e Harruar' nga Kushtrim Bektashi – Moscow International Film Festival – Kategoria: Programi jashtë konkurrencës (Bashkëprodhim i Maqedonisë Veriore, Kosovës dhe Shqipërisë)



Arritje të rëndësishme janë edhe sukseset e filmbërësve dhe aktorëve të cekura më poshtë:

Aktorët Kosovar kanë shkëlqyer në FilmFestival Cottbus në Gjermani duke u shpërblyer me çmime kryesore. Pesë aktoret nga filmi 'Shpia e Agës', Rozafa Çelaj, Adriana Matoshi, Shengyl Ismajli, Melihate Qena dhe Rebeka Qena shpallën aktoret më të mira të festivalit;

Dy çmime për filmin 'Shpia e Agës' në Stamboll në Bogazici Film Festival;

'Në mes' nga Samir Karahoda nominohet për akademinë e çmimeve europiane të filmit;

Në ceremoninë e ndarjes së çmimeve në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit në Vilnius të Lituanisë në kuadër të garës së filmave të shkurtër triumfoi filmi 'Në Mes' i autorit Samir Karahoda, ndërsa filmi debutues i More Raçës i cili u prezantua në Festivalin Ndërkombëtar të San Sebastian-it në Spanjë fitoi çmimin e Glocal in Progress;

Just Film Works in Progress në Black Nights Film Festival i jep çmimin filmit debutan 'Familja' me skenar dhe regji nga Durim Kryeziu dhe me producent Bardhyl Bejtullahun.



## DITËT E FILMIT NË PËRKUJTIM TË FARUK BEGOLLIT

Në 12 vjetorin e vdekjes së ikonës të kinematografisë kosovare, Faruk Begolli, QKK organizoi ditët e filmit në kujtim të Faruk Begollit në bashkëpunim me Kosovafilmin dhe Drejtorinë e Kulturës të Komunës së Prishtinës, për të kujtuar dhe nderuar veprën e aktorit.

U ftuan kolegët, studentët, adhuruesit, dhe filmdashësit të vijnë me 23, 24 dhe 25 gusht në kinemanë Cineplexx të shikojnë tre filma të përzgjedhur në të cilët luan Faruk Begolli.

U shfaqën filmat: Era dhe Lisi, Kur Pranvera Vonohet dhe Proka në kinemanë Cineplexx në Prishtinë.

# Ditët e filmit



Në kujtim të Faruk Begollit

23-25  
Gusht



**23** Era dhe Lisi  
20:00 Cineplexx

**24** Kur Pranvera Vonohet  
20:00 Cineplexx

**25** Proka  
20:00 Cineplexx

## JAVA E FILMIT PËR SHËNIMIN E DITËS TË ÇLIRIMIT TË PRISHTINËS

Qendra Kinematografike e Kosovës në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës dhe Kino Armatën për nder të njëzet vjetorit të çlirimit të qytetit të Prishtinës organizoi 'Javën e Filmit për Shënimin e Ditës së Çlirimit të Prishtinës'.

Java e Filmit u mbajt gjatë javës së tretë të muajit qershor (17-23 qershor) në Kino Armata. Filmdashësit kishin mundësinë të shikojnë filma të ndryshëm të prodhuar në Kosovë të përkrahur nga Qendra e Kinematografike e Kosovës. Këta filma në një formë apo tjetër trajtojnë tematika dhe rrëfejnë storje që lidhen me tranzicionin e shoqërisë Kosovare gjatë viteve të 90ta duke spikatur aspektet sociale e ekonomike.

Pas shfaqjës së filmave u organizuan bashkëbiseda në mes krijuesëve të filmave të shfaqur dhe publikut pjesëmarrës.

Filmat që u shfaqën ishin:

"Ajo" nga More Raça

"Martesa" nga Blerta Zeqiri

"Një Muaj" nga Zgjim Terziqi

"Daullet e Rezistencës" nga Mathieu Jouffre

"Gardhi" nga Lendita Zeqiri

"me dasht' me dasht' me dasht'" nga Ilir Hasanaj

"Tisa" nga Valter Lucaj

"Përtej Rrugës" nga Yll Çitaku

"Ferdonija" nga Gazmend Bajri

"Histori Maje Kulmi" nga Gazmend Nela

"Shok" nga Jamie Donoghue

"Kanarinët e Dinë" nga Kaltrina Krasniqi

"Babai" nga Visar Morina



## JAVA E FILMIT TË KOSOVËS NË BUJANOC

Qendra Kinematografike e Kosovës në bashkëpunim me Këshillin Nacional Shqiptar dhe Shtëpinë e Kulturës të Bujanocit, për vitin e dytë me radhë organizuan Javën e Filmit të Kosovës në Bujanoc. Java e filmit u mbajt në Shtëpinë e Kulturës në Bujanoc, nga 20 deri 24

dhjetor ku u shfaqën katër filma të metrazhit të gjatë dhe dy të metrazhit të shkurtër të realizuar në vitet e fundit në Kosovë me përkrahjen e Qendrës Kinematografike në Kosovë.

Java e filmit u hap me filmin e propozuar nga Kosova për çmimet OSCARS, “Zana” nga Antoneta Kastrati dhe vazhdoi me filmin “Echo” nga Dren Zherka, “Pranverë e Paharruar në Fshatin e Harruar” nga Kushtrim Bekteshi, “Babai” nga Visar Morina, “Në mes” nga Samir Karahoda, duke u përmbyllur me filmin e nominuar në OSCARS 2016 “Shok” nga Jamie Donoughue.

# JAVA E FILMIT TË KOSOVËS NË BUJANOC

20-24 DHJETOR  
SHTËPIA E KULTURËS - BUJANOC



## **PUNËTORI PËR SHKRIM SKENARI**

Qendra Kinematografike e Kosovës në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane në Kosovë dhe programi American Film Showcase organizuan punëtorinë 5 ditore për shkrim të skenarit për serial televiziv, ku morën pjesë filmbërës, skenaristë dhe producentë të shquar kosovarë.

Punëtorja u mbajt nga Jill Goldsmith, e cila është skenariste dhe producente me fame botërore që ka shkruar dhe prodhuar për seriale fituese të çmimeve Emmy si NYPD Blue, The Practice, Ally McBeal, Law & Order, and Boston Legal, ku dhe në vitin 2008 ka qenë finaliste për Humanitas Prize, si dhe ka qenë folëse në univerzitetet, konferenca, dhe programe të shkrimit të skenarëve.



## **Punëtori - Shkrimi i Skenarit për Serial Televiziv me JILL GOLDSMITH**

**23 deri 27 shtator në Prishtinë**



AMERICAN  
**FILM**  
SHOWCASE



Jill Goldsmith është skenariste dhe producente që ka shkruar dhe prodhuar për seriale fituese të çmimeve Emmy si NYPD Blue, The Practice, Ally McBeal, Law & Order, and Boston Legal, dhe në 2008 ka qenë finaliste për Humanitas Prize.

Për të aplikuar për punëtorinë dërgoni CV-në dhe letër-deklaratën motivuese në adresën [lum.citaku@qkk-rks.com](mailto:lum.citaku@qkk-rks.com) dhe [info@qkk-rks.com](mailto:info@qkk-rks.com) deri më 8 shtator, 2019, ora 18:00 me subjektin: Aplikim për Punëtorinë për Shkrim Skenari për Serial Televiziv.

### **PUNËTORI PËR PRODUCENTË**

Qendra Kinematografike e Kosovës në partneritet me Organizatën e Sipërmarrësve Evropianë Audiovizivë nga Franca, EAVE, organizuan një punëtori katër-ditore në Prishtinë për zhvillim të projekteve filmike ku marrën pjesë producentët dhe skenaristët e 9 projekteve të filmave të metrazheve të gjata të përkrahur nga QKK-ja që kanë potencial ndërkombëtar të bashkëprodhimit.

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte zhvillimi i skenarëve dhe përmirësimi i aftësive të bashkëprodhimit të pjesëmarrësve që të mund të sigurojnë mjetet e nevojshme për të pasur sukses në tregun ndërkombëtar.

Punëtorja u udhëhoq nga ekspertë të nivelit të lartë që ndanë përvojën e tyre të EAVE në trajnimin dhe krijimin e rrjetit ndërkombëtar si dhe në bashkëpunim me pjesëmarrësit punuan në krijimin e qasjeve të veçanta për secilin projekt që producentët kosovarë të mund t'i aplikojnë në punën e tyre në të ardhmen.

Punëtorja ishte e ndarë në ligjerata nga ekspertët, seanca të punës në grupe, si dhe takime individuale për pjesëmarrësit në mes të ekspertëve të EAVE dhe producentëve dhe ekipeve të filmave. Temat e trajtuara në formë të ligjeratave ishin: Realizimi i Skenarit, Roli i Producentit, Shitjet, Shpërndarja dhe Tregu Ndërkombëtar.

### **PROPOZIMI PËR OSCARS 2019**

Filmi debutues i Antoneta Kastratit, 'Zana', që pati premeirën e tij botërore në festivalin e madh të Torontos në Kanadë është përzgjedhur nga komiteti selektues që të jetë propozimi i Kosovës për kategorinë Best International Feature të OSCARS.

Filmi 'Zana' është një dramë tronditëse dhe emocionuese që përcjellë një grua të re kosovare që përpiqet të bëhet nënë përderisa ballafaqohet me tmerret nga e kaluara e saj e errët e kohës së luftës.

Komiteti Selektues prej shtatë anëtarëve i aprovuar nga Akademia e Çmimeve OSCARS ishte e përbërë nga kineastë kosovar:



Fatos Berisha – Producent (Kryesues)  
Doruntina Basha – Skenariste  
Shkumbin Istrefi – Aktor/Prodcent  
More Raça – Regjisore  
Visar Krusha – Skenarist/Producent  
Ilir Gjocaj – Skenarist  
Jeton Neziraj – Skenarist



## **PUNIMET PËR DRAFT-LIGJIN E RI PËR KINEMATOGRAFI**

Qendra Kinematografike e Kosovës organizoi grupin punues për hartimin e draft-ligjit të ri për kinematografi.

Grupi punues u kryesua nga Drejtori i QKK-së, Arben Zharku, ndërsa anëtarët e grupit punues ishin: Ilire Vinca (Kryesuese Këshillit Drejtues në QKK dhe Profesoreshë e Aktrimit), Brikena Mulliqi (DIEKP i MKRS-së dhe Anëtare e Këshillit Drejtues në QKK), Feim Hoxha (u.d. i DKRS-së në MKRS-së), Valon Kashtanjeva (nga ZDA e MRKS-së), Betim Jahaj (DL i MRKS-së), Servet Likaj (DBF i MRKS-së), Besë Hajdari (DKP e MRKS-së), Blerta Basholli (Drejtoreshë e Shoqatës së Producentëve), Kreshnik Berisha (Producent dhe montazher, i ftuar pas formimit të grupit punues si këshillues jashtëm), Fatos Berisha (Regjisor dhe Producent, i ftuar pas formimit të grupit punues si këshillues i jashtëm), Liridon Cahani (nga RTK dhe Producent), Blerta Zeqiri (Regjisore), Drilona Belallari (Zyrtare Ligjore në QKK), Ilir Gjocaj (nga Kosova Filmi dhe si Skenarist) dhe Lum Çitaku (Zyrtarë i lartë në QKK, Regjisor dhe Antropolog Vizuel).

Grupi punues ka mbajtur katërmëdhjetë (14) takime punuese gjatë muajve maj, qershor, korrik dhe gusht. Gjatë këtyre takimeve ishin prezent ekspertë të ndryshëm nga institucionet shtetërore si: Thesari i Kosovës, Agjencia kundër Korrupsionit dhe Agjensioni Kosovar i Privatizimit, për të këshilluar në aspektet që ndërlidhen me sektoret e këtyre institucioneve.



## **PREMIERAT GJATË VITIT 2019**

- Film i metrazhit të shkurtë 'Në mes' nga Samir Karahoda – Berlin International Film Festival – Kategoria kryesore: Filmat e shkurtë në Berlinale (Prodhim i Kosovës)
- Film i metrazhit të gjatë 'Shpia e Agës' nga Lendita Zeqiraj – International Film Festival Karlovy Vary – Kategoria: East of the west (Filmat nga ish-blloku socialist) (Bashkëprodhim i Kosovës, Kroacisë, Francës dhe Shqipërisë)

- Film i metrazhit të gjatë 'Zana' nga Antoneta Kastrati – Toronto International Film Festival – Kategoria: Discovery (Zbulimi)  
(Bashkëprodhim i Kosovës dhe Shqipërisë)
- Film i metrazhit të gjatë 'Cirku Fluturues' nga Fatos Berisha – Tallinn Black Nights Film Festival – Kategoria kryesore: Filmat e gjatë në Tallinn  
(Bashkëprodhim i Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë)
- Film i metrazhit të gjatë 'Ekzil' nga Visar Morina – Sundance Film Festival – Kategoria: Konkurenca e dramës më të mire botërore  
(Bashkëprodhim i Kosovës, Belgjikës dhe Gjermanisë)
- Film i metrazhit të gjatë 'Pranverë e Paharruar në Fshatin e Harruar' nga Kushtrim Bektashi – Moscow International Film Festival – Kategoria: Programi jashtë konkurrencës  
(Bashkëprodhim i Maqedonisë Veriore, Kosovës dhe Shqipërisë)
- Film i metrazhit të gjatë 'Fusha e Mëllenjave' nga Arzana Kraja – PriFilm Fest – Kategoria: Hapja zyrtare e festivalit  
(Bashkëprodhim i Kosovës, Anglisë dhe Shqipërisë)
- Film i metrazhit të gjatë 'Derë e Hapur' nga Florenc Papas – Sarajevo Film Festival – Kategoria kryesore: Filmat e metrazhit të gjatë  
(Bashkëprodhim i Maqedonisë Veriore, Kosovës dhe Shqipërisë)

## **MBLEDHJA PËRKUJTIMORE PËR ARZANA KRAJËN**

Qendra Kinematografike e Kosovës, bashkë me komunitetin artistik organizoi mbledhjen përkujtimore për regjisoren Arzana Kraja në Teatrin Kombëtar me datën 15 nëntor 2019, për të përkujtuar jetën dhe veprën e regjisores Kosovare, ku u shfaqen edhe ekstrakte nga filmat e saj.



## **PJESËMARRJA NË TREGJE TË FILMIT**

Qendra Kinematografike e Kosovës këtë vit ka vazhduar prezencën e saj në tregjet më të mëdha ndërkombëtare të filmit në Berlinale (Gjermani) dhe Cannes (Francë). Poashtu, ka qenë prezente edhe në tregun ballkanik të filmit - Balkan Film Market (Shqipëri), si dhe në fshatin e bashkëprodhimit Les Arcs (Francë).



## **BERLINALE**

Në janar dhe fillim të shkurtit 2019, përveç përgaditjeve rreth festivalit të Berlinales dhe për premierën e filmit kosovar 'Në Mes' në kategorinë kryesore të filmave të shkurtë, Qendra Kinematografike e Kosovës ishte e pranishme në European Film Market që ndodh njëkohësisht me Festivalin.

Edhe këtë vit, QKK ishte në shtandin e përbashkët me Qendrën Kombëtare të Kinematografisë së Shqipërisë ku u promovuan filmat kosovar në të gjitha fazat e zhvillimit (para-produksion, në-produksion, pas-produksion, të përfunduar dhe të lansuar të vitit 2018-2019).

Në Berlinale gjithashtu u nënshkrua marrëveshja në mes QKK-së dhe Tatino Films e cila gjashtë muaj më vonë ua mundësoi filmbërësve kosovarë trajnimin, këshillimin dhe mbikqyrjen nga ana e 5 ekspertëve ndërkombëtarë për projektet e filmave fitues të metrazhit të gjatë në fazën e post-produksionit.

## **CANNES**

Qendra Kinematografike e Kosovës ka vazhduar prezencën me pavijon në tregun e filmit Marche Du Film në Cannes, i cili është një prej tregjeve më të mëdha në botë, duke ndarë pavijonin bashkë me Qendrën Kombëtare të Kinematografisë së Shqipërisë. U promovuan filmat e fundit kosovar në kategori dhe faza të ndryshme të zhvillimit, si dhe u mbajtën shumë takime me partnerë ndërkombëtar të kinematografisë, fonde filmi, përfaqësues të festivaleve të mëdha ndërkombëtare dhe producentë e distributor të ndryshëm.

Në këto takime, përveç projekteve në zhvillim u prezantua edhe potenciali i madh i filmbërësve Kosovarë, puna që po bënte QKK-ja për të promovuar filmat e Kosovës, bashkëpunimin dhe

bashkëprodhimin ndërkombëtar, sukseset e fundit më të mëdha, përkrahja gjithnjë në rritje e institucioneve kosovare për filmin, si dhe zhvillimet dhe planet për lehtësirat financiare që priten të bëhen pjesë e ligjit të ri për kinematografinë.



## **BALKAN FILM MARKET**

Në vitin e tretë të Balkan Film Market të organizuar nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë së Shqipërisë, u vazhdua puna në drejtim të lidhjeve të bashkpunimit në mes shteteve të ballkanit dhe rajonit në fushën e kinematografisë.

Qendra Kinematografike e Kosovës ishte pjesëmarrëse edhe në Panelin 'Projeksionet e Ardhshme të Institucioneve Rajonale Kinematografike në një epokë ndryshimesh', panel i cili u zhvillua në kuadër të edicionit të 3-të Balkan Film Market në Tiranë.

Pjesëmarrës në këtë panel ishin përfaqësuesit e qendrave ballkanike të filmit:

Eduart Makri – Kryetar i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë në Shqipëri

Sehad Cekic – Kryetar i Qendrës së Filmit të Malit të Zi

Arben Zharku – Drejtor i Qendrës Kinematografike të Kosovës dhe

Panos Thomaidis – Përfaqësues i Qendrës Greke të Filmit

## **LES ARCS COPRODUCTION VILLAGE**

Qendra Kinematografike e Kosovës ishte prezente në fshatin e bashkëprodhimit Les Arcs në Francë, në kuadër të festivalit ndërkombëtar të filmit 'Les Arcs' ku do të prezentohen dhe promovohen filmat dhe projektet e Kosovës të përkrahura nga QKK-ja.

## **PARTNERITETET DHE BASHKËPUNIMET NDËRKOMBËTARE**

Gendra Kinematografike e Kosovës viteve të fundit është përkujdesur me intenzitet të lartë në avancimin e producentëve kosovar duke nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me tregun e bashkëprodhimit të festivalit evropian të njohur Les Arcs European Film Festival në Francë si dhe me Rotterdam Lab, pjesë e International Film Festival Rotterdam në Holandë.

Këto bashkëpunime do të vazhdojnë gjatë vitit 2020, pasi që ndihmojnë zhvillimin e producentëve në arenat ndërkombëtare duke e parë shumë të nevojshme avancimin e tyre dhe filmbërjen në Kosovë.

Gjithashtu, QKK-ja i ka kushtuar rëndësi të veçantë zhvillimit sa më të madh të bashkëpunimeve ndërkombëtare. Me këtë rast është inicuar hartimi i draftit të bashkëprodhimit ndërkombëtarë me Francën i cili është në process. Në të njëjtën kohë është në proces anëtarësimi i QKK-së në Eurimages.



## **SOUTH EASTERN EUROPE CINEMA NETWORK**

Vazhdon bashkëpunimi me Rrjetin e Fondeve të Filmit të Europës Juglindore (South Eastern Europe – SEE Cinema Network), i cili ka mbështetur tri projekte filmike nga Kosova.

Në Asambleshën e 30-të të mbajtur me 7 nëntor në Selanik, në kuadër të projekteve filmike fituese nga shtetet tjera të Europës Juglindore, është vendosur që të përkrahet prodhimi i dy filmave të shkurtë: 'Koagulimi'/'Coagulation' me skenar dhe regji nga Noar Sahiti dhe 'Sea By The River And River By The Sea'/'Deti buzë lumit dhe lumi buzë detit' me skenar dhe regji nga Sovran Ndrecaj; si dhe zhvillimi i skenarit për filmin e gjatë 'Woman of the House'/'Gruaja e shtëpisë' nga Fatos Berisha.

Për Kosovën është viti i dytë si anëtare e SEE Cinema Network e cila ka për qëllim të krijoj bashkëpunim në mes shtetave anëtare që përmes kinemasë të eksplorohet e përbashkëta e identitetit europian, duke integruar dhe festuar diversitetin kulturor dhe traditat e ndryshme.

### **LES ARCS, FRANCË**

Vazhdon marrëveshja e bashkëpunimit me Festivalin Ndërkombëtar të Filmit 'Les Arcs'. QKK-ja është shumë e interesuar të ruaj këtë marrëveshje edhe në vitet në vazhdim pasi që është mundësi shumë e mire për lidhje të kontakteve si dhe për avancim të producentëve Kosovarë.

### **ROTTERDAM LAB, HOLANDË**

Rotterdam Lab është punësoria për producentët në zhvillim, me të cilët QKK ka pasur marrëveshje edhe sivjet, kështu duke mbështetur producentët e ri të jenë pjesë e punësorisë të Rotterdam Lab dhe të prezantojnë projektet e tyre filmike debutuese.

### **CINEUROPA, BELGJIKË**

Qendra Kinematografike e Kosovës ka vazhduar bashkëpunimin me Cineuropa edhe në vitin 2019, për promovimin e filmave kosovarë në botë përmes newsletters dhe artikujve për filmat Kosovar të cilat Cineuropa i shpërndanë në gjithë Evropën dhe botën.

Cineuropa është magazina më e madhe e industrisë së filmit, e cili i dha QKK-së dukshmëri të madhe ndërkombëtare, pasi që ka databazë tejet të pasur të industrisë së filmit në botë. QKK-ja përmes newsletters që dërgon çdo muaj ishte e pranishme në të gjitha mediumet ndërkombëtare.

### **MARRËVESHJA ME FIRST CUT LAB, GJERMANI**

Gjashtë muaj pas nënshkrimit të marrëveshjes në Berlinale në mes të Qendrës Kinematografike të Kosovës Tatino Films, në korrik u mbajt punësoria 4-ditore e cila iu mundësoi filmbërësve kosovarë trajnimin, këshillimin dhe mbikqyrjen nga ana e 5 ekspertëve ndërkombëtarë për projektet e filmave të tyre fitues të metrazhit të gjatë të cilat janë në fazën e post-produksionit.

Në këtë edicion të parë të punësorisë me First Cut Lab përfitues ishin dy projektet filmike të metrazhit të gjatë: 'Në kërkim të Venerës' nga Norikë Sefa dhe 'Galaktika e Andromedës' nga More Raça.



## **MARRËVESHJA ME FAMU, ÇEKI**

Vazhdon bashkëpunimi përmes Memorandunit të Mirëkuptimit në mes shkollës së filmit dhe televizionit të Akademisë së Arteve të bukura në Pragë – FAMU dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Qendrës Kinematografike të Kosovës, për ofrimin e mundësisë së edukimit audio-vizuel për qytetarët e Republikës së Kosovës në Çeki.

Bursa e plotë që ndahet nga Ministria e Kulturës, iu jep mundësi filmbërësve që të studiojnë në programin Bachelor (në rast se e flasin gjuhën çeke) dhe në programin Master në drejtimet: regji, skenar dhe kamerë (drejtor fotografie) në gjuhën angleze.

Akademia e Arteve të Bukura FAMU në Pragë është themeluar në vitin 1947 duke qenë kështu një ndër shkollat më të vjetra në botë, dhe sipas gazetës Hollywood Reporter është shkolla numër një në Evropë dhe e njëmbëdhjeta në botë. Të diplomuar nga kjo shkollë janë shumë regjisor dhe skenarist të njohur ndërkombëtarisht, si fitues të çmimeve Oskar ose laureat të festivaleve ndërkombëtare të filmit. Ndër të tjerë aty kanë studiuar edhe Milos Forman, Emir Kusturica dhe të tjerë.

Vazhdimi i marrëveshjes u nënshkrua edhe sivjet, ndërsa përfitues të bursës deri më tani janë 4 studentë kosovar: Norika Sefa, Dritëro Mehmetaj, Noar Sahiti, dhe Enis Saraçi.

## **MARRËVESHJA ME EAVE, FRANCË**

Qendra Kinematografike e Kosovës vazhdon bashkëpunimin me EAVE, Organizatën e Sipërmarrësve Evropianë Audiovizivë nga Franca, me të cilën ka nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi 3-vjeçar në vitin 2017.

EAVE ofron një trajnim profesional për zhvillimin e projekteve filmike dhe për krijimin e kontakteve mes producentëve nga e gjithë bota, ku përmes saj përfitojnë producentët kosovar, të cilët pranohen në këtë trajnim. Trajnimi intenziv që ofrojnë për një vit është i ndarë në tri punëtori.

Kjo organizatë është themeluar në vitin 1988 për t'i bashkuar producentët nga vendet e ndryshme të botës, me synimin e lehtësimit të marrëdhënieve për bashkëprodhim. EAVE ka për

qëllim kontributin në krijimin e rrjeteve të fuqishme të kontakteve, të cilat do të forcojnë prodhimin e pavarur në të gjithë botën.

### **ANËTARËSIMI NË BORDIN E EUROPEAN FILM PROMOTION**

Në mbledhjen e fundit të European Film Promotion të mbajtur në Kanë të Francës me 21 maj 2019, drejtori i Qendrës Kinematografike të Kosovës Arben Zharku është zgjedhur anëtar i bordit të drejtorëve të institucionit prestigjioz të filmit – European Film Promotion (EFP).

EFP-ja është një rrjet ndërkombëtar unik i 38 agjencive kombëtare të promovimit të filmave nga e gjithë Evropa që përfaqësojnë filmat dhe talentin e tyre kombëtar jashtë vendit. Me flamurin e EFP-së, këto organizata anëtare vijnë së bashku për të promovuar diversitetin dhe frymën e kinemasë, talentin evropian në festivalet dhe tregjet kryesore filmike ndërkombëtare, e veçanërisht jashtë Europës. EFP mbështetet financiarisht nga Programi Creative Europe - MEDIA e Bashkimit Evropian dhe nga organizatat e saj anëtare.



### **CEREMONIA E EUROPEAN FILM AWARDS, GJERMANI**

Qendra Kinematografike e Kosovës është patron e European Film Awards (EFA) dhe kësaj ishte e pranishme në ceremoninë e ndarjes së çmimeve të EFA në Berlin, e cila njihet si Oscars i Evropës. Në këtë ngjarje prezent ishin: drejtori i QKK-së – Arben Zharku, aktori Astrit Kabashi dhe aktori Vedat Osmani.

Gjatë këtij viti në EFA me propozim të drejtorit të QKK- së është anëtarësuar Besnik Krapo si filmbërës kosovar në Akademinë prestigjioze të Filmit Evropian.



## VIZITË BASHKËPUNIMI NË TURQI

Qendra Kinematografike e Kosovës është e interesuar në thellimin e raporteve Kosovë – Turqi në fushën e Kinematografisë me çrast delegacioni kosovar i përbërë nga drejtori i QKK-së Arben Zharku dhe sekretari i përgjithshëm i MKRS-së Veton Firzi udhëtuan për në Stamboll ku patën takime me përfaqësues të fondeve të filmit.

## PROJEKTET FITUESE TË KONKURSIT TË QKK-së

Në muajin maj është hapur konkursi vjetor për subvencionim të projekteve filmike dhe kanë konkurruar 81 projekte.

Me datën 25 korrik janë prezentuar projektet që kanë kaluar fazën e parë të përzgjedhjes në kategoritë (1) filmit të metrazhit të shkurtër artistik, (2) zhvillim skenari, (3) Postproduksion për film të metrazhit të gjatë, (4) projekti filmik i gjatë dokumentar dhe (5) projekti filmik i shkurtër dokumentar.

Pas kësaj, juria vlerësuese e përbërë nga: Arzana Kraja (e ndjerë), Visar Krusha, Besa Luci, Ilir Bajri, Bujar Luma, Lura Limani, Alban Muja kanë vendosur të mbështesin këto projekte:

Në kategorinë e filmit të metrazhit të shkurtër artistik janë mbështetur 3 projekte filmike:

- Projekti filmik i metrazhit të shkurtër artistik, 'Prishtinë, 2002' me skenar dhe regji nga Trëndelina Haliti, producent Ermal Gërdoci, nga shtëpia filmike Kandërr, mbështetet me vlerë: 20,000.00 € (njetzetë mijë euro)
- Projekti filmik i metrazhit të shkurtër artistik, 'Adelina' me skenar dhe regji nga Rita Krasniqi, producent Jon Gojani, nga shtëpia filmike Tusk Motion Pictures, mbështetet me vlerë: 20,000.00 € (njëzetë mijë euro)
- Projekti filmik i metrazhit të shkurtër artistik, 'Një fëmijë' me regji dhe skenar nga Bekim Guri dhe producent Ilir Hasanaj, nga shtëpia filmike 'Unseen' SH.P.K., mbështetet me vlerë: 15,000.00 € (pesëmbëdhjetë mijë euro)

Në kategorinë zhvillim skenari janë mbështetur 6 projekte filmike:

- Projekti filmik për zhvillim skenari 'Kur t'ecë koha kadale' me skenar nga Dhurata Hoti, dhe producent Petrit Ukëhajdaraj, nga shtëpia filmike N.SH. 'Shortcut', mbështetet me vlerë: 5,000.00 € (pesëmijë euro)
- Projekti filmik për zhvillim skenari 'Gruaja e shtëpisë' me skenar dhe regji Fatos Berisha dhe producent Vjosa Berisha, nga shtëpia filmike N.SH. B2-PR & Media Solution, mbështetet me vlerë: 5,000.00 € (pesëmijë euro)
- Projekti filmik për zhvillim skenari 'Burek' me skenar dhe regji nga Ismet Sijarina dhe producent Leonora Lushtaku, nga shtëpia filmike N.T.SH. Thumbs up, mbështetet me vlerë: 5,000.00 € (pesëmijë euro)
- Projekti filmik për zhvillim skenari '2000: A post war Odyssey' me skenar Zgjim Terziqi dhe producent Zgjim Terziqi, nga shtëpia filmike Broken Branch Production SH.P.K., mbështetet me vlerë: 5,000.00 € (pesëmijë euro)
- Projekti filmik për zhvillim skenari 'Fjollat' me skenar dhe regji Kushtrim Hoxha dhe producent Erblin Polloshka, nga shtëpia filmike Audience Production SH.P.K., mbështetet me vlerë: 5,000.00 € (pesëmijë euro)

- Projekti filmik për zhvillim skenari 'Azil' me skenar dhe regji Jeton Ahmetaj dhe producent Ylli Ahmetaj, nga shtëpia filmike Shtëpia filmike dhe teatrore Film Mission, mbështetet me vlerë: 5,000.00 € (pesëmijë euro)

Në kategorinë e Postproduksion për film të metrazhit të gjatë, juria vendosi të mbështes 3 projekte filmike:

- Projekti filmik Postproduksion për film të metrazhit të gjatë 'Zbulimi i fundit' me regji nga Burim Haliti, skenar dhe producent Xhelal Haliti, nga shtëpia filmike N.SH.'Eureka Film & Production', mbështetet me vlerë: 15,000.00 € (pesëmbëdhjetë mijë euro)
- Projekti filmik Postproduksion për film të metrazhit të gjatë 'Njeriu me këmishë' me regji dhe skenar nga Luan Kryeziu, producent Agron Kryeziu, nga shtëpia filmike 'Iliria Film', mbështetet me vlerë: 15,000.00 € (pesëmbëdhjetë mijë euro)
- Projekti filmik Postproduksion për film të metrazhit të gjatë 'Shpata e drunit' me regji nga Emre Onuk, skenar Selman Kilicaslan dhe producent Agon Uka, nga shtëpia filmike N.T.SH.'Infinity Production', mbështetet me vlerë: 15,000.00 € (pesëmbëdhjetë mijë euro)

Në kategorinë e projekti filmik i gjatë dokumentar, juria vendosi të mbështes 4 projekte filmike:

- Projekti filmik i gjatë dokumentar 'Fëmijët e Parajsës më të ulët' me skenar dhe regji nga Brigitte Staemose dhe producent Visar Arifaj, nga shtëpia filmike Kabineti, mbështetet me vlerë: 70,000.00 € (shtatëdhjetëmijë euro).
- Projekti filmik i gjatë dokumentar, 'Go Go Kosovo' me skenar dhe regji nga Jane Stockdale dhe producente Ilinka Ilioska, nga shtëpia filmike Raven City Production, mbështetet me vlerë: 20,000.00 € (njetëmijë euro)
- Projekti filmik i gjatë dokumentar, 'Atdhe' me skenar dhe regji nga Kreshnik Jonuzi dhe producent Ardian Sharku, nga shtëpia filmike 'Buka' Sh.P.K., mbështetet me vlerë: 20,000.00 € (njetëmijë euro)
- Projekti filmik i gjatë dokumentar, 'Refugjatët kosovar në Mal të Zi 1999' me skenar dhe regji nga Velibor Covic dhe producent Festim Bajgora nga shtëpia filmike "XYZ" SH.P.K., mbështetet me vlerë: 20,000.00 € (njetëmijë euro)

Në kategorinë e projekti filmik i shkurtër dokumentar, juria vendosi të mbështes 3 projekte filmike:

- Projekti filmik i shkurtër dokumentar, 'Table Stories' me skenar dhe regji nga Samir Karahoda dhe producent Eroll Bilibani, nga shtëpia filmike D.P.Sh. 'SK Pictures', mbështetet me vlerë: 15,000.00 € (pesëmbëdhjetë mijë euro)
- Projekti filmik i shkurtër dokumentar, 'Bloom' me skenar dhe regji nga Edin Alija dhe producent Haris Alija, nga shtëpia filmike 'Kandërr' Sh.P.K., mbështetet me vlerë: 10,000.00 € (dhjetë mijë euro)
- Projekti filmik i shkurtër dokumentar, 'Okul' me skenar dhe regji nga Berkant Curri dhe producent Sezgin Curri, nga shtëpia filmike 'Divan Production' L.L.C., mbështetet me vlerë: 7,500.00 € (shtatëmijë e pesëqind euro)

Me datën 27 korrik janë prezentuar projektet që kanë kaluar fazën e parë të përzgjedhjes në kategoritë (6) filma të metrazhit të gjatë – artistik, (7) filma të metrazhit të gjatë artistik – debutant dhe (8) filma të metrazhit të gjatë artistik – Koproduksion Minor.

Juria vlerësuese për projektet e metrazhit të gjatë artistik, debutant dhe koproduksion minor ishte e përbërë nga Isa Qosja, Simona Nobile, Jeton Neziraj, Kaltrina Krasniqi, Ilir Gjocaj, Agim Poçari dhe Ilir Ajdini. Pasi shqyrtuan projektet e paraqitura në konkurs, vendosën t'i mbështesin këto projekte:

Në kategorinë e filmit të metrazhit të gjatë – artistik janë mbështetur 4 projekte filmike:

- Projekti filmik i metrazhit të gjatë artistik, 'Hotline' me skenar dhe regji Dren Zherka, producent Bujar Kabashi, nga shtëpia filmike N.SH. N'Art, mbështetet me vlerë: 200,000.00 € (dyqind mijë euro)
- Projekti filmik i metrazhit të gjatë artistik, 'Toka brenda meje' me skenar dhe regji nga Fisnik Magjuni dhe producent Valon Bajgora, nga shtëpia filmike sh.p.k Ikonë Studio, mbështetet me vlerë: 200,000.00 € (dyqind mijë euro)
- Projekti filmik i metrazhit të gjatë artistik, 'Ngjyrat' me skenar Xheraldina Vula, regji Burbuqe Berisha dhe producent Agron Vula, nga shtëpia filmike N.Sh. AB- FILM, mbështetet me vlerë: 150,000.00 € (njëqind e pesëdhjetë mijë euro)
- Projekti filmik i metrazhit të gjatë artistik, 'I love you more' me skenar dhe regji nga Erblin Nushi dhe producent Lulzim Guhelli, nga shtëpia filmike Tilia Entertainment Sh.P.K., mbështetet me vlerë: 130,000.00 € (njëqind e tridhjetë mijë euro)

Në kategorinë e filmit të metrazhit të gjatë artistik – debutant janë mbështetur 2 projekte filmike:

- Projekti filmik i metrazhit të gjatë artistik të regjisorëve debutant, 'Këngë për lule' me skenar Roland Spahiu, regji Baris Karamuco dhe producent Tahar Alemndar, nga shtëpia filmike Fabrika KS, mbështetet me vlerë: 50,000.00 € (pesëdhjetë mijë euro)
- Projekti filmik i metrazhit të gjatë artistik të regjisorëve debutant, 'Okarina' me skenar Albana Muja, regji Alban Zogjani dhe producent Shpend Zogjani, nga shtëpia filmike ASHA SH.P.K., mbështetet me vlerë: 50,000.00 € (pesëdhjetë mijë euro)

Në kategorinë e metrazhit të gjatë artistik – Koproduksion Minor, juria vendosi të mbështes 4 projekte filmike:

- Projekti filmik i metrazhit të gjatë artistik - koproduksion minor, 'Sirin' me skenar dhe regji nga Senad Sahamovic dhe producent Fatmir Spahiu, nga shtëpia filmike "Buka" SH.P.K., mbështetet me vlerë: 37,000.00 € (tridhjetë e shtatë mijë euro)
- Projekti filmik i metrazhit të gjatë artistik - koproduksion minor, 'M' me skenar dhe regji nga Vardan Tozija dhe producent Gazmend Nela, nga shtëpia filmike In my Country Porstproduction Sh.p.k., mbështetet me vlerë: 50,000.00 € (pesëdhjetë mijë euro)
- Projekti filmik i metrazhit të gjatë artistik - koproduksion minor, 'Virgjëresha shqiptare' me skenar Karia Kittendorf, regji nga Bujar Alimani dhe producent Besnik Krapo, nga shtëpia filmike "Circle Production" Sh.P.K., mbështetet me vlerë: 70,000.00 € (shtatëdhjetë mijë euro)
- Projekti filmik i metrazhit të gjatë artistik - koproduksion minor, 'Sister' me skenar dhe regji nga Dina Duma dhe producent Liridon Cahani, nga shtëpia filmike "Added Value Films" Sh.P.K., mbështetet me vlerë: 50,000.00 € (pesëdhjetë mijë euro)

## PROJEKTET NË ZHVILLIM

Përveç gjashtë premierave të rëndësishme ndërkombëtare të filmave të mbështetur nga Qendra Kinematografike e Kosovës, shumë projekte të tjera filmike janë momentalisht në faza të ndryshme të zhvillimit. Gjatë këtij viti kanë filluar xhirimet e rreth 20 filmave të kategorive të ndryshme, prej të cilëve 12 projekte filmike i kanë përfunduar ato, disa kanë arritur në fazën e post-produksionit, një pjesë e tyre janë ende në xhirim, ndërsa deri me tani përafersisht 10 filma kanë marrë lejen të shfaqen.



## PLANI 2020

Gjatë vitit 2020 Qendra Kinematografike e Kosovës pret që ligji i draftuar nga grupi punues gjatë këtij viti të kalojë fazat e degjimeve publike dhe të hyjë në fuqi. Ky ligj përbrenda tij përveç përditësimit me të rehat e fundit në filmbërje dhe përshtatjes ndaj kontekstit të zhvillimeve të fundit në bashkëprodhimin ndërkombëtar të filmit, ai integron edhe rregulloren për lehtësirat financiare e cilat do të tërheq investime të huaja në Kosovë në fushën e industrisë së filmit.

QKK-ja planifikon që ta rrisë aktivitetin ndërkombëtar të promovimit të filmave dhe shkëmbimit profesional me qendrat, organizatat dhe institucionet e rëndësishme evropiane dhe botërore të filmit. Poashtu planifikon që të rrisë aktivitetin me projekte që ndërlidhin filmin dhe prodhimet audiovizuale me edukimin. Me këtë njëkohësisht edhe rritjen e aktivitetit në vend përmes vazhdimit të intensifikimit të rolit të QKK-së në rivitalizimin dhe krijimin e rrjetit të kinemave publiko-private të Kosovës.